



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1680/2 prot.

Tiranë, më 18. 12. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 309, datë 18. 12. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 209, datë 15.11.2021, që i përket K. D., kundër M. B., në cilësinë e ish Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, me pretendimin për diskriminimin bindjes politike<sup>3</sup> dhe gjinisë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

K. D. ka punuar në pozicionin e Administratores së Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës, nga data 15.05.2018 deri në datën 10.10.2019, aksionere e së cilës me 100% të vlerës së kapitalit është Bashkia Vau i Dejës. Emërimi në detyrë i ankueses është kryer nëpërmjet Vendimit nr. 2, datë 15.05.2018, të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës me afat të caktuar nga data 15.05.2018, deri në datën 15.05.2021.

Me shkresën nr. 4544 prot., datë 15.08.2019, e Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, me lëndë “Njoftim” drejtuar ankueses K. D., i është kërkuar që të paraqesë pranë Zyrës së Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë dokumentacionin e themelimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e performancës. Në vijim, nëpërmjet Vendimit nr. 50, datë 10.10.2019, të Asamblesë së Shoqërisë, ankuesja është shkarkuar nga detyra me motivacionin e mospërbushjes së detyrave dhe mungesës së bashkëpunimit. K. D. sqaron se shkarkimi i saj nuk

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Referuar Vërtetimit nr. 77, datë 12.11.2021, të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Vau i Dejës.

ka ardhur si pasojë e performancës, pasi shkaku i vërtetë konsiston në bindjen politike dhe gjininë e saj. Ankuesja thekson faktin se ajo dhe pjesëtarë të familjes së saj janë anëtarë të strukturave të Partisë Demokratike, si dhe në momentin e largimit ajo ka qenë e vetmja drejtuese femër në të gjitha nivelet drejtuese të shoqërive, në të cilat Bashkia Vau i Dejës është aksionere. Njëkohësisht, K. D. pretendon se ka qenë edhe e vetmja drejtuese femër në të gjithë Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. në Shqipëri. Ajo thekson faktin se në vendin e saj është emëruar një Administrator i gjinisë së kundërt, me anëtarësi në Partinë Socialiste. K. D. pretendon se Administratori i ri i Ujësjiellës Kanalizime sh.a., z. I. B., është emëruar në të njëjtën ditë, në të cilën ajo është shkarkuar nga detyra, me Vendimin nr. 51, datë 10.10.2019, të Asamblesë së Shoqërisë. Ky fakt sipas saj reflekton dhe është provë e drejtpërdrejtë, që largimi i saj është politik dhe i paramenduar, pasi emërimi i Administratorit të ri duhet kryer brenda një afati kohor 15-30 ditor.

K. D. sqaron gjithashtu se në vijim të largimit nga puna, në datën 18.04.2021 është djegur makina, që është në pronësi të biznesit të saj familjar dhe që përdorej nga ajo dhe vëllai i saj, z. A.D., i cili është Kryetar i grupseksionit të PD në Shelqet Vau i Dejës dhe të dy janë delegatë në Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike. Ankuesja pretendon se djegia e makinës është kryer për shkaqe politike dhe çështja është ende duke u hetuar nga ana e organit të prokurorisë. Ankuesja thekson faktin se nga momenti i djegies së makinës, ajo ka marrë dizeni dhe ka krijuar bindjen mbi faktin që vendimi për largimin e saj nga puna është diskriminues për shkak të bindjes së saj politike dhe gjinisë.

Ankuesja sqaron gjithashtu se votimi për largimin e saj nga detyra është kryer nga anëtarët e rinj të Asamblesë së Shoqërisë, përkatësisht shtetasit E. P., K. Th. dhe I. B., të cilët janë emëruar në detyrë si anëtarë të kësaj Asambleje, me Vendimin nr. 49, datë 10.10.2019. Anëtarët e rinj, të emëruar me aktin e sipërcituar, kanë votuar shkarkimin e saj, pa u regjistruar ende pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Sipas ankuses, regjistrimi i tyre është kryer në vijim të largimit të saj.

Kuadri rregullator i marrëdhënieve të punës ndërmjet Administratorit dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. konsiston në parashikimet e Vendimit nr. 63, datë 27.01.2016, të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, në legjislacionin mbi shoqëritë tregtare, si dhe në dispozitat e Kodit të Punës. K. D. ka sqaruar gjithashtu se marrëdhënia e punës ndërmjet Administratorit dhe Shoqërisë është një marrëdhënie e veçantë<sup>4</sup>, por që gjithsesi mbetet një marrëdhënie pune, që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës. Sipas saj, Vendimi nr. 50, datë 10.10.2019, i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. nëpërmjet së cilit ajo shkarkohet nga detyra, është në kundërshtim me nenin 21/1 të Kodit të Punës. Zgjidhja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të menjëherëshme, pa respektuar afatin e njoftimit si dhe pa shkaqe të justifikuar.

Ankuesja shprehet se ka depozituar padi me objekt – konstatimin e paligjshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kjo gjykatë është shprehur me

---

<sup>4</sup> Referuar nenit 18, pika 5, të Vendimit nr. 63, datë 27.01.2016, të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” parashikohet se: “Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe Administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar”.

vendim për rrëzimin e kërkesëpadisë së saj, vendim, i cili është kundërshtuar nga ana e K. D. në Gjykatën e Apelit.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1575/1 prot., datë 23.11.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Vau i Dejës, si dhe për dijeni ankueses, ku kërkohej informacion i hollësishëm mbi pretendimet e saj.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Vau i Dejës dërgoi shkresën nr. 6741/1 prot., datë 03.12.2021, nëpërmjet së cilës sqaroi se me Vendimin nr. 50, datë 10.10.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a., është vendosur shkarkimi i K. D., nga detyra e Administratores së Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a., për arsye

të mospërbushjes së detyrave të parashikuara në nenin 21, pika 7, gërmat ç), d), e), i), të Statutit të Shoqërisë, dhe si pasojë e mungesës totale të bashkëpunimit.

Bashkia Vau i Dejës, gjithashtu sqaroi se shkeljet e kryera nga ish-Administratorja e UK Vau i Dejës sh.a. konsistojnë, si më poshtë:

- Në shkelje të nenit 21, pika 7, gërmat ç), d), e), të Statutit të Shoqërisë, ish administratorja e UK Vau i Dejës sh.a. nuk ka njohur organin e Asamblesë së Përgjithshme, duke i mbajtur të fshehtë dhe duke refuzuar të dorëzojë dokumentacionin e shoqërisë si bilance etj., për një periudhë gati 2 mujore, duke kërkuar dokumentacione konfirmimi, jashtë çdo parashikimi ligjor dhe duke tejkalluar në mënyrë abuzive kompetencat ligjore<sup>5</sup>. Në shkresën e Bashkisë Vau i Dejës theksohet fakti se ankuesja ka shkelur parimin e mirëbesimit sipas dispozitave të Kodit të Punës, sikurse edhe parimin e të drejtës së informimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901/2008 “*Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, të ndryshuar.
- Ish-Administratorja e kësaj shoqërie ka refuzuar regjistrimin e publikimeve të detyrueshme për shoqërinë (*konkretisht vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për lirim nga detyra të anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit të Administrimit*), në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar në VKM nr. 63, datë 27.01.2016, “*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*”, neni 18, pika 7/1. Një gjë e tillë ka shkaktuar dhe penalizimin me gjobë nga ana e QKB-së ndaj Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Vau i Dejës, në shumën 15.000 lekë, për mosveprim brenda afateve ligjore.
- Ish-Administratorja e Shoqërisë UK Vau i Dejës ka vepruar në tejkallim të hapur të kompetencave të saj. Kështu, në referencë të nenit 7/d të VKM-së së sipërcituar përcaktohet shprehimisht se është tagër e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar. Ish-Administratorja ka vepruar në kundërshtim me këtë parashikim dhe ka tentuar në mungesë të dokumentacionit ligjor dhe në mungesë të vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme, ka aplikuar pranë QKB-së për rritje të kapitalit të shoqërisë. Ky veprim është pezulluar nga QKB, në çështjen nr. CN-34823-09-19, me arsyetimin ligjor se aplikimi nuk është plotësuar në të gjitha të dhënat e detyrueshme.
- Ish-Administratorja e UK Vau i Dejës nuk ka përdorur efektivisht të ardhurat e shoqërisë duke sjellë si pasojë, pamundësinë financiare të likuidimit të detyrimeve të sigurimeve shoqërore, veprim ky i shoqëruar me bllokim të llogarive bankare të shoqërisë dhe njëkohësisht të Kryetarit të Këshillit të Administrimit, z. B. N., duke e vendosur shoqërinë në kolaps.

---

<sup>5</sup> Referuar shkresës “Kthim përgjigje nr. 305, datë 26.08.2018, ku refuzohet dërgimi i dokumentacionit tek Asambleja e Përgjithshme me justifikimin se: “Për çdo dokumentacion duhet vendimi i Këshillit të Bashkisë për caktimin e kryetarit të Asamblesë”

- Ish- Administratorja ka refuzuar bashkëpunimin dhe ka injoruar kërkesën e Këshillit të Administrimit për të vendosur në dispozicion dokumentacionin që shërben për njohjen e gjendjes së shoqërisë dhe performancën e administratorit;

Në kuadrin e shkeljeve të rënda të detyrave të parashikuara nga neni 21 i Statutit, pika 7, gërmat ç), d), e) dhe i), si dhe në shkelje të dispozitave të nenit 158, pika 3, të ligjit nr. 9901/2015 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, solli shkarkimin e menjëhershëm për shkelje të rënda të Administratorit të Shoqërisë, K. D.. Në këtë kontekst, Bashkia Vau i Dejës sqaroi se në gjykimin e këtij institucioni, pretendimi i K. D. se është larguar nga detyra për motive politike rrëzohet, pasi ka arsye mëse të mjaftueshme për shkarkimin e saj nga detyra.

2. Në vijim, me shkresën nr. 128, datë 18.01.2022, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 11.02.2022, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës theksoi faktin se shkarkimi nga detyra i K. D. është bërë për shkak të shkeljeve të saj, dhe jo për shkak të bindjes së saj politike apo gjinisë. Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës u shpreh se ankuesja ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, padi me objekt konstatimin e paligjshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës etj., nëpërmjet Vendimit nr. 50, datë 10.01.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës sh.a. dhe kjo gjykatë është shprehur nëpërmjet vendimit 520(2660), datë 21.07.2020, ku ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë. Ankuesja sqaroi se rrëzimi i kërkesëpadsisë nga ana e gjykatës është mbështetur në arsyetimin se mosmarrëveshja e paraqitur për gjykim nuk rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, por nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statuti i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës” sh.a. dhe dispozitat e Kodit Civil për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimit kontraktor. Ajo theksoi faktin se vendimi i sipërcituar ishte ankimuar brenda afatit ligjor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe ishte në pritje të vendimmarrjes së kësaj gjykate.

Bashkisë Vau i Dejës iu kërkua në seancë dëgjimore, informacion i mëtejshëm lidhur me çështjen e K. D..

3. Në vijim të seancës dëgjimore, përmes shkresës<sup>6</sup> nr. 281/1 prot., datë 18.02.2022, Bashkia Vau i Dejës dërgoi informacionin e kërkuar pranë KMD-së.
4. Në vijim të procedurave hetimore, KMD kërkoi informacion nga AKUM<sup>7</sup>, lidhur me performancën e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Vau i Dejës dhe ish-Administratores K. D., gjatë periudhës kohore që ajo ka drejtuar këtë shoqëri, si dhe një vlerësim krahasimor të performancës së kësaj shoqërie, me periudhën kohore para se K. D. të merrte në administrim këtë shoqëri, si dhe me periudhën pas lirimit të saj nga detyra.
5. Nëpërmjet shkresës nr. 439/1, datë 17.03.2022, AKUM i ktheu përgjigje KMD-së, duke dërguar në formë tabele të dhëna të përgjithshme për periudhën 2017-2020, si dhe rezultatet e arritura në kontratat e performancës të nënshkruara ndërmjet AKUM dhe Bashkisë Vau i Dejës.

<sup>6</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 128/2, datë 23.02.2022.

<sup>7</sup> Akronim i Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve;

6. Shkresat e sipërcituara të AKUM dhe Bashkisë Vau i Dejës iu dërguan për dijeni ankueses K. D., përmes e-mail-it datë 10.02.2022.

Në vijim, ankuesja depozitoi informacione të tjera plotësuese, si dhe me e-mail-in e datës 27.04.2022, e bën me dije KMD-së mbi Vendimin nr. 50-2022-626, datë 26.04.2022, e Gjykatës së Apelit Shkodër, nëpërmjet së cilit është vendosur prishja e Vendimit nr. 520 (2660), datë 21.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e çështjes për rigjykim po pranë kësaj gjykate, me një trup tjetër gjykses. Në këto kushte, K. D. kërkoi që procedurat e shqyrtimit të ankesës së saj pranë KMD-së të pezullohen, deri në momentin që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër të shprehet me vendim, lidhur me ligjshmërinë e zgjidhjes së kontratës së saj të punës.

7. Në kushtet kur, çështja objekt ankese pranë KMD-së, ka lidhje të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen e gjykatës mbi ligjshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës së K. D., për periudhën kohore që ajo ka punuar në detyrën e Administratores së Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Vau i Dejës, si dhe mbështetur në nenin 85, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkua nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi çmoi se procedurat për shqyrtimin e ankesës duhet të pezullohen, deri në momentin, kur palët do të depozitojnë në cilësi prove vendimin gjyqësor, lidhur me çështjen objekt gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për këtë me vendimin Nr. 88, datë 17.05.2022, vendosi pezullimin e procedurës administrative, lidhur me shqyrtimin e ankesës nr. 209 Regj., datë 15.11.2021, të K. D., deri në momentin, kur palët në proces shqyrtimi administrativ të depozitojnë në cilësi prove, vendimin gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi ligjshmërinë e largimit nga puna të K. D..

8. Me e-mail-in datë 26.11.2024, Bashkia Vau i Dejës vuri në dijeni Komisionerin, lidhur me propozimin për zgjedhjen me negociim të çështjes me nr. 209, datë 15.11.2021, drejtuar K. D..

9. Sa më sipër, K. D., përmes e-mail-it datë 02.12.2024, informoi Komisionerin lidhur me korrespondencën e mbajtur me Bashkinë Vau i Dejës, ku ndër të tjera kishte sqaruar se: *“U njoha me propozimin tuaj për ta zgjidhur me mirëkuptim mosmarrëveshjen që unë e kam ankimuar te Komisioneri Kundër Diskriminimit. Zgjidhja më e drejtë e që do të rregullonte të gjitha pasojat, duhet të përfshinte dhe një kompensim monetar. Gjithsesi, propozimi juaj mbetet pozitiv. Unë me këtë e-mail jap pëlqimin tim me kushtin që: heqjen dorë nga ankimi pranë Komisionerit Kundër Diskriminimit ta paraqes pasi të nënshkruhet kontrata e punës”*.

10. Në vijim, përmes e-mail-it datë 03.12.2024, Bashkia Vau i Dejës, i përcolli për dijeni Komisionerit e-mail-in drejtuar K. D., ku ndër et tjera citohet se: *“Në vijim të e-mailit që keni dërguar e ku jepni miratimin tuaj në parim për zgjidhjen me pajtim e mbylljen pa vendim përfundimtar të procedurës pranë Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit me kushtin që të njiheni konkretisht me pozicionin e punës, ju informojmë se jemi të gatshëm për*

*lidhjen e një kontrate pune në pozicionin e këshilltarit të Kryetarit”. Bashkëngjitur gjeni aktin e emërimit.*

*Lidhur me pretendimet tuaja financiare, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ju mund të vijoni ndjekjen e procesit gjyqësor me SHA, pasi tejkalon kompetencat funksionale të institucionit...”*

Bashkëngjitur e-mail-it të sipërcituar, Bashkia Vau i Dejës vuri në dispozicion të Komisionerit, Urdhrin nr. 716, datë 02.12.2024 “Për emërim në detyrë të një punonjësi”, ku evidentohet se K. D. është emëruar në pozicionin e Këshilltares së Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës.

**11.** Me e-mail-in datë 05.12.2024, K. D., informoi Komisionerin lidhur me korrespondencën e mbajtur me Bashkinë Vau i Dejës, sa i përket emërimit në detyrë, duke theksuar ndër të tjera se: *“...Po ju drejtohem lidhur me propozimin tuaj përfundimtar. Pasi u njoha me ndryshimet e Ortakërisë së Shoqërisë Ujës-jellës Kanalizime Vau Dejës SHA, shprehem dakord me zgjidhjen e ofruar nga ana juaj! Sipas zotimit tim, heq dorë nga shqyrtimi në themel i ankimit të paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit. Ndërkohë, kërkimin tim lidhur me rregullimin e pasojave financiare të zgjidhjes së kontratës do ja kundrejtoj Shoqërisë së re të krijuar. Ju falënderoj për zgjidhjen e ofruar...”*

Neni 68, i Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se: *“Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme 1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme: a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar; b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm; c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj. 2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkaku i parashikuar në pikën 1, të nenit 67, të këtij Kodi”*.

Në këto kushte, referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Vau i Dejës, lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen me marrëveshje të ankesës për diskriminim të K. D., Komisioneri çmon se është siguruar informacioni i mjaftueshëm për çeljen e procedurës së shqyrtimit të ankesës. Në këtë kuptim, me vendimin Nr. 308, datë 18. 12. 2024, vendosi ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 209, datë 15.11.2021, të ankueses K. D..

Në vijim, duke qenë se ankuesja, nëpërmjet emailit të dërguar me datë 05.12.2024, është tërhequr nga ankimi i bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar se përmes masave të marra nga Bashkia Vau i Dejës dhe ndërmjetësimit të Komisionerit, është zgjidhur me marrëveshje ankesa për diskriminim, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës Nr. 209, datë 15.11.2021, të K. D., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet politike dhe gjinia)  
(Fusha: Punësim)